



Pranuar / Dorezuar Punë/Prodatë Received/Delivery	01.11.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Hr. Prof B. Prof Prof No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	6634/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.586/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arditë Haxhnikaj-Demi-anëtar me Arditë Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar sipas Aktgjykimit me numër A.nr.1948/2021, të datës 22.09.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative,ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.586/2021 të datës 23.06.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë

kundër organit të punësimit/Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës-ish Ministria e Infrastrukturës, në çështjen juridike "vlerësim i punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 01.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.586/2021 e datës 23.06.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës-ish Ministria e Infrastrukturës, sipas akt emërimit të datës 17.04.2012, në pozitën "Udhëheqës i divizionit të rregullimit ekonomik dhe licencimeve" në kuadër të Departamentit të Autoritetit të Aviacionit Civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, fillimisht me datën 02.04.2021 ka nxjerrë Vendimin me numër A.nr.87/2021, sipas të cilit ka vendosur lidhur me ankesën e

ankuesit të datës 18.02.2021 për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 dhe të njëjtën e ka kthyer në rivlerësim tek organi i punësimit konkretisht tek Sekretari i Përgjithshëm i kësaj ministrie dhe Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, duke i marrë për bazë udhëzimet e dhëna në vendim. Me datën 29.04.2021 përmes Formularit 1 të rezultateve në punë të nëpunësve civil, Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, ka bërë rivlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin sipas udhëzimeve të dhëna të Këshillit dhe të njëjtin e ka vlerësuar me notën e përgjithshme 2.76. Me datën 19.05.2021 si dhe 30.04.2021, përmes e-mailit zyrtar Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore në ish Ministrinë e Infrastrukturës ka njoftuar Këshillin se është zbatuar Vendimi me numër A.nr.87/2021 i datës 02.04.2021, lidhur me rivlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin dhe ka bashkangjitur formularin e rivlerësimit të rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2020 nga Udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë.

I pakënaqur me rivlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 nga Udhëheqësi i drejtpërdrejtë, ankuesi me datën 23.06.2021 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 3272/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 04.08.2021 përmes njoftimit me numër protokollit 4074/2021 e ka njoftuar ankuesin lidhur me arsyen e mos shqyrtimit të ankesës së tij, sepse Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën plenare të mbajtur me datën 30.06.2021, ka shkarkuar pesë (5) anëtarët e Këshillit dhe si rezultat i kësaj ka mbetur pa anëtar-kuorum, mirëpo të njëjtin e ka udhëzuar se mund të ndjek procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera, duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datën 22.09.2022 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.1948/21, i cili në Këshill është pranuar me datën 04.10.2022 sipas të cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 04.08.2021, duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 23.06.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 3272/2021 të datës 23.06.2021 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në kërkesë me numër protokollit 4089/2021 të datës 04.08.2021 nga Ministria e Infrastrukturës lidhur me provat shtesë për ankesën e ankuesin; Kërkesën për përgjigje në provat shtesë përmes e-mailit zyrtar të datës 02.08.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailat zyrtar lidhur me sigurimin e provave për ankuesin nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i tij të datës 03.08.2021, 23.04.2021, 02.09.2020, 01.09.2020, Projekt rregulloren MPB Nr.00/2020 për vendosjen e kriterëve të lejuar derogimin nga standardet e përbashkëta themelore mbi sigurimin e aviacionit civil dhe miratimin e masave alternative të sigurimit; E-mailat zyrtar të datës 24.03.2021, 18.01.2021, 03.08.2021, 12.05.2020, 08.05.2020, 15.04.2020, 21.12.2020, 17.12.2020,



16.12.2020, 02.07.2020, 23.04.2021 lidhur me sigurimin e provave për ankuesin, 22.04.2022; E-mailin zyrtar të datës 14.05.2021 lidhur me ankesën e ankuesit tek kryesuesja e kolegjit të Këshillit; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të ankuesit për vitin 2020 të datës; E-mailat zyrtar të datës 27.04.2021, 23.04.2021; Vendimin me numër A.nr.87/2021 të datës 02.04.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e ankuesit me numër protokollit 704/2021 të datës 18.02.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve të shërbimeve publike për periudhën janar-mars të vitit 2020 për pozitën "Ushtrues detyre i Drejtorit të Departamentit të Aviacionit Civil: Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve të shërbimeve publike për periudhën mars-dhjetor të viti 2020 nga Drejtori i Departamentit të Aviacionit Civil për pozitën " Udhëheqës i divizionit të rregullimit ekonomik-Departamenti për Aviacionin Civil-Ministria e Infrastrukturës"; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019; Plani i punës -2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2019; Plani i punës për vitin 2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2017; Plani i punës për vitin 2017; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2016; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2014; Aktgjykim me numër A.nr.971/15 i datës 06.03.2018 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 01.03.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në ankesë e datës 11.03.2021 nga Ministria e Infrastrukturës me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa lejuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, fillimisht ndërlidhur me ankesën e ankuesit e dërguar përmes e-mailit zyrtar të datës 14.05.2021, konstaton se e njëjta nuk është adresuar konformë Rregullores 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Formularit të rivlerësimit të rezultateve në punë të datës 29.04.2021 i nxjerrë nga Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i tij, kolegji ka analizuar Rregulloren 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konkretisht paragrafin 1 të nenit 3 të kësaj rregulloreje, ku ka përcaktuar në mënyrë decidive mënyrat e dërgimit të ankesave, e që janë: "1.1.personalisht ose nga i autorizuari i tij, 1.2.përmes postës së zakonshme apo të certifikuar si dhe 1.3.në mënyrë elektronike në adresën zyrtare të Këshillit të përcaktuar në nenin 4 të kësaj rregulloreje", andaj nisur nga ky fakt Kolegji ka konstatuar se mënyra e dërgimit të ankesës së ankuesit të datës 14.05.2021, përmes e-mailit zyrtar direkt të anëtarja të Këshillit është në kundërshtim me procedurën ligjore të paraparë në Rregulloren 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ndërlidhur me ankesën e ankuesit me numër protokollit 3272/2021 të datës 23.06.2021, e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi ka analizuar shkresat e lëndës e ndërlidhur me afatshmërinë e së njëjtës, ka konstatuar se ankuesi Formularin lidhur me rivlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 të datës 29.04.2021 e ka pranuar po me këtë datë, në të

cilin ka dhënë edhe komentet lidhur me atë se nuk është i kënaqur me rivlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 dhe po ashtu të njëjtin e ka nënshkruar, ndërsa ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar me datën 23.06.2022, e që është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se : *“Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve , nga data kur është njoftuar për aktin administrativ”*, andaj në kuptim të kësaj dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesa e ankuesit është e pa lejuar.

Andaj, duke u bazuar në nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda,A.nr.586/2021, datë 01/11/2022.

Ardita PERÇUKU-SHYTI



Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.